

VENDIM
Nr. 511, datë 13.9.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRIT
TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit, të fushave të përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është të ndihmojë dhe të mbrojë sipërmarrjen private, që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, si dhe të promovojë bashkëpunimin ndërinstitucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes.

3. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes e ushtron veprimtarinë e tij në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) Investigon dhe trajton ankesat administrative të sipërmarrjeve private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe/ose të huaj, kundrejt institucioneve publike, të cilat përfshijnë institucionet publike të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike si dhe të zyrtarëve të tyre;

b) Promovon transparencën dhe bashkë-punimin ndërinstitucional, për përmirësimin e shërbimeve publike, si dhe asiston sipërmarrjen në mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore të lidhura me aktivitetet e tyre sipërmarrëse, kundrejt institucioneve publike;

c) Ndërmjetëson komunikimin e sipërmarrjes me institucionet publike për zbatimin e kontratave, si dhe zhvillon mekanizma të zgjidhjes paraprake të mosmarrëveshjeve midis tyre;

ç) Inkurajon zhvillimin e partneritetit dhe komunikimit midis institucioneve publike dhe sipërmarrjeve, si dhe organizatave përfaqësuese të tyre.

4. Me qëllim realizimin e veprimtarisë si më sipër, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes:

a) krijon platformën elektronike të ndërveprimit me sipërmarrjen për komunikimin dhe gjurmimin e ankesave të tyre;

b) krijon regjistrin e komunikimit të brendshëm të trajtimit të ankesave, përmes së cilit monitoron procesin ndërinstitucional dhe i raporton Kryeministrit çdo fillim muaji;

c) krijon rregulloren e procedurës së brendshme, e cila detajon procedurën e:

i) regjistrimit dhe të pranimit të ankesave, sipas kriterëve të përcaktuara në rregullore;

ii) komunikimit dhe të investigimit të çështjeve të pranuar me institucionet e lidhura publike;

iii) mbledhjes së evidencave dhe të informacionit të nevojshëm nga institucione të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike dhe/ose personave të tretë;

iv) komunikimit midis institucioneve publike dhe të sipërmarrjes që ka kryer ankimimin; si dhe

v) raportimit dhe publikimit të statusit të ankesave të trajtuara.

5. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes nuk trajton çështje për të cilat është hapur një çështje gjyqësore, dhe/ose ka një vendim gjyqësor të formës së prerë.

6. Ngarkohet ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama